



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 491 prot.

Tiranë, më 31. 03. 2020

Lënda: Rekomandim për zgjerimin e listës së subjekteve përfituese të ndihmës financiare, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19, në referim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 254, datë 27.3.2020.

Z. ARBEN AHMETAJ
MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN 
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

Znj. OGERTA MANASTIRLIU
MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Adresa: Rruga e Kavajës, Nr. 1001, Tiranë

AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark, Ish Shtëpia e Ushtarakëve, Kati VII" Tiranë

Për dijeni:

KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

TIRANË

Të nderuar,

Në kuadër të:

- ✓ ushtrimit prej Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me statusin e institucionit të pavarur publik, të atributëve që i jepen prej Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;
- ✓ zbatimit të nenin 32, pika 1, germa "ë", të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010, i cili parashikon :

“Komisioneri ka kompetencë t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”.

- ✓ sensibilizimit për të marrë të gjitha masat e duhura, përfshirë ndërhyrjet në legjislacion, për të modifikuar ligjet, rregulloret dhe praktikat ekzistuese, me qëllim nxitjen e parimit të barazisë dhe ndalimin e cdo lloj diskriminimi,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashtroi Rekomandimin si më poshtë:

I. QËLLIMI DHE ANALIZA E LEGJISLACIONIT TË ZBATUESHËM

Qëllimi i këtij Rekomandimi është zgjerimi i listës së kategorive përfituese të ndihmës financiare, gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 254, datë 27.3.2020 *“Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19”*¹.

Synimi kryesor është gjithëpërfshirja e grupeve të ndryshme shoqërore të cilat pavarësisht ndryshimit të statuseve ligjore ku bëjnë pjesë rezultojnë të përjashtuara dhe për rrjedhojë, mund të rezultojnë të diskriminuara direkt për shkak të gjendjes ekonomike dhe gjendjes shoqërore. Njëkohësisht mund të ekzistojnë premisat për diskriminim indirekt për shkak race, etnie apo përkatësie në grup të veçantë, lidhur kryesisht me komunitetet Rome dhe Egjiptiane, por edhe me kategori të tjera të cilat nuk marrin asnjë lloj përfitimi nga mekanizmat e mbrojtjes shoqërore.

Në funksion të analizës juridike për hartimin e këtij Rekomandimi, rezulton se, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 254, datë 27.3.2020, janë parashikuar si vijon:

Qëllimi: Dhënie e ndihmës financiare, gjatë gjendjes së epidemisë nga COVID-19.

Subjektet Përfituese:

- ✚ të vetëpunësuarit/të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për periudhën pas ndërprerjes së aktivitetit ekonomik/ marrëdhënive të punës për shkak të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19
- ✚ individët që përfitojnë pagesë të ndihmës ekonomike.
- ✚ individët që përfitojnë pagesën e të ardhurës nga papunësia.

Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi:

- Ministri i Shtetit për Rindërtimin

¹ Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 53 / 2020.

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA)
- Shërbimi Social Shtetëror.

Efektet në kohë: 1 prill 2020 deri në përfundim të gjendjes së epidemisë nga COVID-19, por jo më shumë se 3 (tre) muaj.

Masa e ndihmës financiare, ekonomike dhe e pagesës të së ardhurës nga papunësia: Siç përcaktohet në Kreun IV të VKM, sipas seciles kategori.

II. REKOMANDIME TË KMD

Në analizë të VKM Nr. 254, datë 27.3.2020 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se ekzistojnë disa diferencime, që rezultojnë në përjashtimin e disa kategorive shoqërore, dhe për këtë arsye, rekomandon si më poshtë:

Së pari: Përfshirjen e kategorisë së të vetëpunësuarëve në veprimtari si “Shitës Ambulant”

Sipas përkufizimit të dhënë në shkronjën “j”, të nenit 5, të ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se: “Ambulant” është personi fizik, i cili tregton mallra ose shërbime për publikun pa pasur një vend biznesi fiks, që ushtron aktivitetin në njësi të vetme tregtimi të lëvizshme dhe lejohet të tregtojë në ambiente publike pasi është pajisur me leje nga bashkia nën juridiksionin territorial dhe administrativ”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi sjell në vëmendje se, në këtë kategori përfshihen kryesisht tregjet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, si tregjet e rrobave të përdorura, gjithashtu edhe ato të fruta-perimeve etj, sipas përkufizimit të Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Rezulton se kjo kategori nuk përfiton në kuadër të kësaj pakete sociale-ekonomike të miratuar nga qeveria shqiptare, për shkak të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, konkretisht nga VKM 254, datë 27.3.2020, prandaj nevojitet që të adresohet.

Së dyti: Përfshirjen e punëkërkesve të papunë, si subjekte përfituese të ndihmës financiare, në zbatim të VKM Nr. 254, datë 27.3.2020.

Në kuptim të Ligjit Nr. 15/2019 “Për Nxitjen e Punësimit”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon përfshirjen, si subjekte përfituese të ndihmës financiare në zbatim

të VKM Nr. 254, datë 27.3.2020, të dy kategorive të punë-kërkuesëve të papunë, të cilët konsistojnë si vijon:

Punëkërkuesit e papunë, të cilët nuk kanë qenë më parë të punësuar dhe për pasojë nuk kanë kontribuar në skemën e sigurimit shoqëror sipas nenit 53 të Ligjit 7703 datë 11/05/1993 “Për sigurimet shoqërore në RSh”, i ndryshuar.

Referuar parashikimeve të aktit nënligjor në fjalë, Komisioneri ka analizuar si më poshtë:

VKM Nr. 254, datë 27.3.2020, ka parashikuar në Kreun IV, pika 3, se “Pagesa e së ardhurës nga papunësia për subjektet përfituese sipas vendimit nr. 161, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”, që rezultojnë përfitues të pagesës të së ardhurës nga papunësia ose kanë aplikuar për të përpara datës 10 mars 2020, do të jetë sa dyfishi i shumës së llogaritur sipas vendimit të sipërpërmendur.”

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 161, datë 21.3.2018 “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”, në pikën 2 parashikon: “2. Përfitojnë të ardhura nga papunësia të gjithë personat e siguruar, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 53, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”

Në vijim, neni 53 i Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon “Kushtet e Përfitimit”, ku shprehimisht thuhet se:

“1. Personat e siguruar përfitojnë të ardhura papunësie, në rast se:

a) kanë kontribuar në sigurimin shoqëror jo më pak se 12 muaj për çdo rast përfitimi dhe
b) janë vërtetuar nga zyra përkatëse e punës se:

- janë punëkërkues të papunë, të gatshëm të punësohen kur iu ofrohet një punë e paguar, e përshtatshme; 20 - pranojnë të kualifikohen ose të rikualifikohen.

c) nuk marrin përfitime të tjera nga ky Ligj, me përjashtim të pensionit të pjesshëm të invaliditetit.”

Ndërkohë që, referuar qëllimit të këtij Rekomandimi, vëmendja e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi drejtohet tek përfshirja në VKM Nr. 254, datë 27.3.2020 edhe e kategorisë së punë-kërkuesëve të papunë, që aktualisht rezultojnë të regjistruar, por që nuk kanë qenë më parë të punësuar dhe për pasojë nuk kanë kontribuar në skemën e sigurimit shoqëror, sikurse kufizohet nga parashikimet shterruese të dispozitave të sipërcituara.

Në këtë proces, vëmendje duhet të kenë edhe punëkërkuesit e disavantazuar në tregun e punës.

Kështu, në referim të Ligjit 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” parashikohen “Grupet e veçanta”, të cilët janë punëkërkues të disavantazuar në tregun e punës, dhe ku përfshihen:

- a) individët me statusin e jetimit që ndodhen në kushte të vështira ekonomike;
- b) kryefamiljarë të vetëm, me fëmijë në ngarkim;
- c) persona me aftësi të kufizuara, përfshirë personat që nuk dëgjojnë dhe invalidët e punës të vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse;

- ç) prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar;
- d) persona me moshë mbi 55 vjeç;
- dh) persona nga komuniteti rom dhe egjiptian;
- e) persona që kanë vuajtur dënimin me burgim, apo ndaj të cilëve është vendosur pezullimi i vendimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me një dënim alternativ;
- ë) persona nga familje që përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura;
- f) punëkërkues të papunë afatgjatë (të regjistruar si punëkërkues të papunë prej më shumë se një viti);
- g) punëkërkues të papunë, të kthyer prej jo më shumë se dy vjetësh nga emigracioni;
- gj) të mitur dhe të rinj në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur;
- h) të rinjtë me moshë nën 29 vjeç;
- i) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;
- j) viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje;
- k) nënat nën moshën 18 vjeç.

Kategoria e punëkërkuesve të disavantazhuar në tregun e punës, kërkon gjithashtu një vëmendje të veçantë, me qëllim përfitimin e të drejtave të parashikuara në VKM nr. 254, datë 27.3.2020, pra dhënies së ndihmës financiare, sipas përcaktimeve të saj.

Së treti, krijimin e lehtësive për regjistrimin e “punëkërkuesve të papunë”, sipas përcaktimeve të Ligjit 15/2019 “Për Nxitjen e Punësimit”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon krijimin e lehtësive për personat që nuk janë deri aktualisht të regjistruar si punëkërkues të papunë, me qëllim krijimin e mundësisë për përfshirjen e kësaj kategorie gjithashtu, si subjekte përfituese të ndihmës financiare, në zbatim të VKM Nr. 254, datë 27.3.2020, në kushtet e vështira, veçanërisht ato ekonomike, me të cilat po përballen familjet shqiptare, si pasojë e gjendjes së epidemisë shkaktuar nga COVID-19.

Kështu, referuar Ligjit 15/2019 “Për Nxitjen e Punësimit”, punëkërkuesit që deklarojnë në strukturën përkatëse, që nuk janë në marrëdhënie pune ose të vetëpunësuar dhe që janë të gatshëm menjëherë për punësim, t’u krijohet mundësia e regjistrimit si “Punëkërkues i papunë”, në koordinim me institucionet e tjera publike, në mënyrë që të shmangen pagesat e dyfishta, dhe, nëse është e mundur me një procedurë të përshpejtuar.

Së fundmi, heqja e datës 10 mars 2020 si afat i fundit për regjistrim si për punëkërkuesit pa punë, sipas nenit 53 të Ligjit 7703/1993, ashtu edhe të punëkërkuesve të papunë që nuk hyjnë në këtë dispozitë sipas këtij Rekomandimi. Gjithashtu heqja e kësaj date si afat i fundit edhe për aplikimin e subjekteve për ndihmë ekonomike.

Si përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kërkon vëmendjen dhe vlerësimin Tuaj për përfshirjen e kategorive të sipër-përmendura në VKM nr. 254, datë 27.3.2020, sipas përmajtjes së këtij Rekomandimi, me qëllim garantimin e përfitimeve, që

ajo ofron, të cilat konsiderohen të arsyeshme dhe në përpjestim me situatën e fatkeqësisë natyrore të shpallur në të gjithë Republikën e Shqipërisë, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, dhe kufizimeve të ndërmarra nga qeveria shqiptare me qëllim parandalimin dhe frenimin e përhapjes së kësaj epidemie në vendin tonë.

Sa më lart, bazuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

REKOMANDON:

➤ Marrjen e masave, përfshirë ato ligjore, për zgjerimin e listës së subjekteve përfituese të ndihmës financiare, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19, në referim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 254, datë 27.3.2020, sipas përmbajtjes së këtij Rekomandimi, me qëllim:

1. Përfshirjen e kategorisë së të vetëpunësuarëve në veprimtari si “*Shitës Ambulant*” në Kreun II të VKM Nr. 254, datë 27.3.2020;
2. Përfshirjen e punëkërkuesve të papunë, si subjekte përfituese të ndihmës financiare, në zbatim të VKM Nr. 254, datë 27.3.2020, të *Punëkërkuesve të papunë, të cilët nuk kanë qenë më parë të punësuar dhe për pasojë nuk kanë kontribuar në skemën e sigurimit shoqëror sipas nenit 53 Ligji 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në RSh”; si dhe kujdes të veçantë për grupet e veçanta sipas Ligjit 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”*
3. Krijimin e lehtësive për regjistrimin e “punëkërkuesve të papunë”, sipas përcaktimeve të Ligjit 15/2019 “Për Nxitjen e Punësimit”, me qëllim krijimin e mundësisë për përfshirjen e kësaj kategorie gjithashtu, si subjekte përfituese të ndihmës financiare, në zbatim të VKM Nr. 254, datë 27.3.2020.
4. Heqjen e datës 10 Mars 2020 si afat i fundit për regjistrimin e punëkërkuesve papunë, gjithashtu edhe për aplikimin për ndihmë ekonomike.

Lutemi përcjelljen e informacionit mbi veprimet e ndërmarra nga ana Juaj, për zbatimin e këtij rekomandimi, brenda një afati sa më të arsyeshëm.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj,

